

Gjykata supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në Seancën e përgjithshme, të mbajtur më 13.07.2021, duke shqyrtuar për iniciativën e parashtruar nga Seanca e gjyqtarëve të Gjykatës themelore Veles SU.nr.20-2/21 nga 02.03.2021, sipas nenit 101 nga Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe të nenit 37 paragrafi 1 pika 1 të Ligjit të gjykatave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 58/2006...96/2019), miratoi:

MENDIM JURIDIK PARIMOR

Këshilli penal për fëmijë, është kompetent të veprojë për kërkesë të parashtruar për zhdëmtimin e fëmijës, për të cilin me vendim të plotfuqishëm gjyqësor është përcaktuar se është viktimë, ose i dëmtuar me veprim që me ligj është paraparë si vepër penale ose kundërvajtje me elemente të dhunës, e të cilit i është pranuar kërkesa juridike pronësore, pavarësisht nga ajo se vendimi i plotfuqishëm gjyqësor me të cilin është vendosur për kërkesën juridike pronësore është miratuar nga gjyqtari penal, për kundërvajtje ose për konteste.

A r s y e t i m

Sipas nenit 151 paragrafi 1 të Ligjit për drejtësi për fëmijë ("Gazeta zyrtare e RM" numër 148 të datës 29.10.2013), për zhdëmtimin e fëmijës që është viktimë ose i dëmtuar nga veprimi që me ligj është paraparë si vepër penale e dhunës dhe akteve tjera të dhunës individuale apo grupe, ndahen mjete në suazat e buxhetit të Ministrisë së Drejtësisë. Në paragrafin 2 të këtij ligji theksohet se Ministri i Drejtësisë, me mendimin e marrë paraprakisht nga Këshilli Shtetëror për Parandalimin e Delikuençës së Fëmijëve, miraton Program vjetor me të cilin i planifikon burimet dhe mënyrën e shpenzimit të mjeteve nga paragrafi 1 i këtij ligji. Në kuptim të paragrafit 3 të këtij ligji çështjet administrative teknike për pagesën e mjeteve nga paragrafi 1 i këtij ligji i kryen Ministria e Drejtësisë.

Sipas nenit 152 paragrafi 1 të këtij Ligji, fëmija për të cilin me vendim të plotfuqishëm gjyqësor është përcaktuar se është viktimë, ose i dëmtuar me veprim që me ligj është paraparë si vepër penale ose kundërvajtje me elemente të dhunës, e të cilit i është pranuar kërkesa juridike pronësore, mund të parashtojë kërkesë për dëmshpërblim nga mjetet nga neni 151 paragrafi 1 të këtij Ligji në gjykatën kompetente, kur nga pengesa faktike ose juridike, kërkesa juridike pronësore nuk mund të kryhet nga prona e kryerësit të veprës penale ose aktit tjetër të dhunës dhe kur nga plotfuqishmëria e vendimit për kërkesën juridike pronësore kanë kaluar më shumë se gjashtë muaj. Në paragrafin 2 të nenit të theksuar thuhet që qëndron se kërkesën nga paragrafi 1 të nenit 152, përveç fëmijës, mund ta paraqesin prindi/ët ose tutori/ët. Në paragrafin 3 të këtij neni qëndron se gjykata do të miratojë aktvendim për dëmshpërblim në shumë të kërkesës së gjykuar pronësore juridike, pa rritje në bazë të kamatës ose shpenzimeve tjera plotësuese lidhur me zbatimin e

kërkesës. Nëse gjykata e refuzon kërkesën, fëmija viktimë ka të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në afat prej 8 ditësh nga dita e marrjes së aktvendimit për refuzim. Vendimi i Gjykatës së Apelit është përfundimtar.

Në nenin 19 të Ligjit për drejtësi për fëmijë, që ka të bëjë me domethënien e nocioneve dhe shprehjeve të përdorura në këtë Ligj, me nocionin “Gjykatë kompetente” nënkuptohet gjykatësi për fëmijë dhe këshilli për fëmijë.

Nëse merret parasysh dispozita ligjore e cituar e nenit 19 të Ligjit për drejtësi për fëmijë, buron se kompetent për të vepruar për kërkesën e dëmshpërblimit të fëmijës për të cilin me vendim të plotfuqishëm gjyqësor është përcaktuar se është viktimë, ose i dëmtuar me veprim që me ligj është paraparë si vepër penale ose kundërvajtje me elemente të dhunës, e të cilit i është pranuar kërkesa juridike pronësore është këshilli penal për fëmijë, pavarësisht nga ajo se vendimi i plotfuqishëm gjyqësor me të cilin është vendosur për kërkesën juridike pronësore është sjellë nga gjyqtari penal, kundërvajtje ose për konteste.

Kjo posaçërisht ngase sipas nenit 152 paragrafi 3 të Ligjit për drejtësi për fëmijë, aktvendimi për dëmshpërblim duhet të jetë në shumë të kërkesës së gjykuar pronësore juridike, pa rritje në bazë të kamatës ose shpenzimeve tjera plotësuese lidhur me zbatimin e kërkesës, nuk është me rëndësi që kërkesa për dëmshpërblim është pranuar nga gjykatë penale apo gjykatë për konteste. Se ajo është ashtu, buron edhe nga aktvendimet e dorëzuara me iniciativën në fjalë. Në fakt, me aktvendimin, KSM.nr.19/20 të datës 25.12.2020, në Këshillin penal për fëmijë të Gjykatës themelore Veles, kërkesa për dëmshpërblimin e fëmijës së mitur përmes përfaqësuesit të tij ligjor – të ëmës, është aprovuar dhe është detyruar Ministria e Drejtësisë të kryejë pagesën për fëmijën e mitur të përfaqësuar nga e ëma e tij për kërkesën e dëmshpërblimit juridik shumë në vlerë prej 200.000,00 denarëve, të përcaktuar me aktgjykim të Gjykatës themelore Veles MALLVP-42/19 të datës 24.06.2019. Kjo buron edhe nga aktvendimi i Gjykatës themelore Manastir P4-9/19 të datës 30.01.2020, me të cilën po ashtu kërkesa e paditëses së mitur, e përfaqësuar nga përfaqësuesja ligjore – e ëma, është aprovuar, dhe është detyruar Ministria e drejtësisë së RMV, t'i paguajë paditëses së mitur përmes të ëmës shumë totale prej 8.000.000,00 denarëve, sipas bazës për kompensim të dëmit jo material, të gjykuar me aktgjykim të Gjykatës themelore Manastir P4-9/19 të datës 23.05.2019, aktgjykim ky që është i plotfuqishëm dhe përfundimtar më 27.06.2019.

Për Ministrinë e Drejtësisë nuk është me rëndësi se kush ka vendosur për kërkesën për dëmshpërblimin nga mjetet nga neni 151 paragrafi 1 të Ligjit për drejtësi për fëmijët. Kjo ngase kjo Ministri sipas nenit 152 paragrafi 4 të Ligjit për fëmijë, vetëm e kryen pagesën me aktvendimin përfundimtar për pagesën e dëmshpërblimit, të cilin aktvendim gjykata e dorëzon edhe për pagesën e kryer, sipas nenit 152 paragrafi 5 nga Ligji i cituar, kjo Ministri e njofton gjykatën që e ka miratuar aktvendimin, më së voni një muaj nga pagesa e kryer. Nëse dëmshpërblimi paguhet nga mjetet nga neni 151 paragrafi 1 të Ligjit për drejtësi për fëmijë, gjykata sipas nenit 152 paragrafi 6 të këtij Ligji, e dorëzon aktvendimin për zhdëmtim të Avokati Shtetëror për ngritjen e procedurës për përmbarrimin e detyrueshëm të dëmshpërblimit të paguar nga prona e kryerësit. Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankese, e ajo do të zbatohet në përputhje me dispozitat e Ligjit për përmbarrim.

Nëse tërë kësaj i shtohet edhe e theksuara në nenin 153 paragrafi 1 të Ligjit për drejtësi për fëmijë, se mbrojtja e fëmijëve si viktimë dhe dëshmitarë në procedurë penale sigurohet në pajtueshmëri me dispozitat e këtij Ligji, Ligji për procedurë penale dhe Ligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve, konsideroj se bëhet fjalë vetëm për procedurë urgjente dhe të ndjeshme, ku fëmija viktimë është e domosdoshme që maksimalisht të mbrohet.

Për këto arsye, Seanca e përgjithshme miratoi këtë mendim juridik parimor.

Gjykata supreme e
Republikës së Maqedonisë së Veriut
Seanca e përgjithshme